



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 23/4, DATË 06 / 06 /2023

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIMIN E STATUSIT
“INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË”
PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “IMPIANTI AGRIVOLTAIK 120 MW”
ME SUBJEKT APLIKUES SHOQËRINË “NATYRE ENERGY” SHPK,
ME NUIS: L72220033M”**

Në mbështetje të Nenit 9, nenit 13, nenit 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 3/c të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 të VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi se:

- Projekti i investimit propozon ndërtimin e një Parku Agri - Fotovoltaik, me një fuqi të instaluar prej 120 MW, në ZK 1984, fshati Imshtë, Njësia Administrative Bubullimë, Bashkia Lushnjë, në pasuritë me numër 187/3, 187/4, 187/5,187/6 dhe 187/7.
- Vlera e investimit për projektin e propozuar parashikohet të jetë 109,483,772 (njëqind e nëntë milion e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy) Euro dhe numri i të punësuarve parashikohet të jetë 158 gjatë fazës së ndërtimit dhe 14 gjatë fazës së operimit.
- Pasuritë e paluajtshme që preken nga projekti i investimit të propozuar ndodhen brenda argjinaturës së lumit Seman.
- Pasuritë e paluajtshme, ku propozohet realizimi i projekti të investimit prekin njësinë strukturore 10/127 duke u mbivendosur edhe me Projektin e Gazsjellësit TransAdriatik (TAP). Ky projekt është miratuar me Vendimin Nr. 1, datë 08.04.2014 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e lejes së zhvillimore komplekse për Gazsjellësin TransAdriatic (Projekti Tap).”

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Impianti Agrivoltaik 120 MW”, me subjekt investues shoqërinë “Natyre Energy” shpk, me NUIS: L72220033M në procedurën e veçantë dhe mbështetjen që ofron ky status.

2. Projekti i investimit bie ndesh me përcaktimet e Ligjit Nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, pasi ai propozohet të zhvillohet në zonën e bregut të lumit Seman, ndërmjet vijës ujore të lumit dhe argjinaturës gjatësore. Projekti, gjithashtu, mbivendoset me projektin e Gazsjellësit TransAdriatik (TAP), në gjurmën e të cilit janë të ndaluara ndërtimet e të gjitha llojeve, nga secila anë e aksit qendror të tubacionit, që është zona e sigurisë.
3. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i njoftohet investitorit.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
DELINA IBRAHIMAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
FRIDA KRIFCA

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT
ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS
SOKOL NANO